



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Mbështetur në nenin 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L-040, nenin 48 parag.1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, nenit 16 të Rregullores për përbërjen, kompetencat dhe rregullat e punës të Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit,

THËRRAS

Mbledhjen e XXXIII (tridhjetë e tre - mandati VI) të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **01 shkurt 2021**, duke filluar nga **ora 10:00, në objektin e ri të Komunës, salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës**, kati përdhes.

Rend dite

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtura më:
29 tetor 2020; 19 nëntor 2020 dhe 29 dhjetor 2020.
2. Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Arsimit
3. Informatë e Përgjithshme e Drejtorisë së Administratës
4. Plotësim i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, pas dhënies së dorëheqjes së një këshilltari nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës
5. Kërkesa e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, për ri shqyrtimin e propozim vendimit për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2021 (*sipas materialit nga mbledhja e datës 30.12.2020*)
6. Kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit për plotësim ndryshimin e Vendimit nr.01-104/02-0065942/20 të datës 30 tetor 2020 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. Podujevë (*riformulim i nenit 2, me tekstin: "Kryetari i Komunës me Vendim të veçantë emëron një anëtar në kuadër të këtij komisioni"*)
7. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës / Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2020

Nr. 01-060/03-0005746/21
Podujevë,
22 janar 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi